



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:228998

Datë: 28.05.2024

Numri i dokumentit: 05741412

KPPP.nr. 90/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përmbarimore të kreditorit Komuna e Klinës, kundër debitorit Kooperativa Bujqësore “Liria”, me seli në fshatin Budisalc, duke vendosur sipas prapësimit të debitorit të ushtruar ndaj Urdhrit Përmbarimor P.nr. 557/23, i lejuar më datë 26.08.2023, nga Përmbaruesi Privat Blerim Baloku, me seli në Pejë, jashtë seancës me datë 28.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET si i bazuar prapësimi i debitorit Kooperativa Bujqësore “Liria”, ashtu që Urdhri Përmbarimor P.nr. 557/23, i lejuar më datë 26.08.2023, nga Përmbaruesi Privat Blerim Baloku, ANULOHET.

A r s y e t i m

Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Komuna e Klinës, mbi bazën e dokumentit përmbarimor, Vendimit 05-Nr. 434-15/41/2023, të datës 20.08.2023, ka lejuar urdhrin përmbarimor P.nr. 557/23, të datës 26.08.2023, me të cilin është urdhëruar debitori Kooperativa Bujqësore “Liria”, që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të urdhrit, t’ia paguaj kreditorit shumën në lartësi prej EUR 1,761.93, me kamatë ligjore duke filluar nga data e krijimit të obligimit, e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Debitori, brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim me të cilin e ka kundërshtuar në tërësi urdhrin përmbarimor me arsyetim se urdhri përmbarimor është marrë në shkelje të dispozitave nga neni 71, par. 1, pika 1.1 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore, ashtu që dokumenti në bazë të së cilit është lejuar urdhri përmbarimor nuk ka tipare të dokumentit përmbarues dhe si i tillë nuk paraqet

titull ekzekutiv. I ka propozuar gjykatës që të aprovojë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhri përmbartimor të anulohet.

Kreditori nuk ka paraqitur përgjigje në prapësim.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (në tekstin e mëtejshëm: “LPP”), gjeti se urdhri përmbartimor duhet të anulohet, për shkaket si në vijim:

Në rastin konkret rezulton se propozimi i kreditorit është ushtruar duke u bazuar në Vendimin 05-Nr. 434-15/41/2023, të datës 20.08.2023, të Komunës së Klinës, Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit, me të cilin debitori është detyruar që kreditori t’ia paguaj borxhin në lartësi prej EUR 1,761.93.

Gjykata gjeti se dokumenti mbi të cilin është propozuar lejimi i përmbartimit dhe mbi bazën e të cili përmbartuesi ka lejuar urdhrin përmbartimor, nuk përbën bazë juridike për caktimin e përmbartimit pasi që nuk paraqet titull ekzekutiv në kuptim të nenit 21 të LPP-së, sipas së cilës dispozitë përcaktohet se: *“Organi përmbartues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbartimin vetëm në bazë të dokumentit përmbartues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*.

Gjykata, duke ju referuar shkresave të lëndës, gjen se Vendimin 05-Nr. 434-15/41/2023 i datës 20.08.2023, mbi bazën e të cilit përmbartuesi privat ka lejuar përmbartimin, nuk ka tipare të përmbartueshmërisë përkatësisht nuk i plotëson kushtet për përmbartim të përcaktuara me nenin 24, paragrafi 3 lidhur me nenin 36 të LPP-së i cili parasheh se *“Së bashku me propozimin për përmbartim, organit përmbartues i dorëzohet edhe Faqe 3 nga 3 dokumenti përmbartues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbartueshmërisë për përmbartueshmëri”* pasi që i njëjti nuk është përmbart klauzolën e plotfuqishmërisë dhe ekzekutueshmërisë, andaj nuk dihet se a është bërë i pambarueshëm sipas rregullave mbi bazën e të cilave është nxjerrë.

Rrjedhimisht, në mbështetje të nenit 71, par.1, nën-par 1.1 të LPP-së me të cilin përcaktohet që prapësimi mund të bazohet nëse *“dokumenti, në bazë të cilit është marr vendimi përmbartues ose urdhri përmbartues, nuk ka titull ekzekutiv ose nuk ka tipare të përmbartueshmërisë”* u vendos si në dispozitivin e këtij aktvendimi, që urdhri për lejimin e përmbartimit të anulohet.

Nga sa më sipër, në kuptim të nenit 71 paragrafi, 1, pika 1.1 dhe 73 të LPP-së, si dhe nenit 13, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 90/24, datë 28.05.2024

Gjyqtari  
Florent Zeqiri

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.